



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke



ZL.Anr.339/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Adnan Konushevci kryesues, Gyltene Sylejmani dhe Ymer Hoxha anëtar, si dhe me pjesmarrjen e Zyrtares Ligjore Arjeta Sylja, duke vendosur përkitazi me ankesën e Luljeta Blakqori nga Prishtina, rruga “Eduard Liri” paraqitur kundër KQZ-së, për shkak të emrit të personit të vdekur në Librin e Votimit, për Zgjedhjet Lokale të dates 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur me 22.10.2017, mori këtë:

V E N D I M

HUDHET si e palejuar ankesa e Luljeta Blakqori nga Prishtina, e cila identifikohet me shenjën ZL.Anr.339/2017 e datës 22.10.2017 me të cilën ka kërkuar që të largohet nga lista e votuesve emëri i bashkëshortit të saj Mehmet Blakqori cili ka vdekur para 6 vitëve dhe të largohet nga lista e votuesve emëri i kumatës së saj Alije Blakqori e cila ka vdekur para dy vitëve.

A r s y e t i m

Me datë 22.10.2017 Luljeta Blakqori nga Prishtina, ka parashtruar ankesë në PZAP, me të cilën ankesë ka pretenduar se, në Qendrën e Votimit 1925E/01R në Prishtinë, në librin e votuesve ka parë emërin e bashkëshortit të saj Mehmet Blakqori e cili ka vdekur qe 6 vite si dhe emrin e kumatës së saj Alije Blakqori e cila ka vdekur qe dy vite.

Paneli, pasi shikoj paraprakisht lejueshmërinë e ankesës gjeti se:

Ankesa është e pa lejuar

PZAP-i, vendos ndaj vendimeve të KQZ-së sipas nenit 122 të LZP-së, prandaj ankesa është e palejuar sepse, nuk është në juridiksionin e PZAP-it, që të ndërmerr masa përmirësuese ndaj listës së votuesve në rastet kur gjenden emra të personave të vdekur në listën e votuesve, ngase një çështje e tillë nuk parashihet me asnjë dispozitë ligjore të LZP-së, që paneli ti korrigjon listat e votuesve duke i larguar emrat e personave të vdekur nga lista.

Andaj duke u bazuar në nenin 6.4 i Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it (Rregullës nr. 02/2015) dhe nenit 118 paragrafi 1 të LZP-së, lidhur me ankesën e lartpërmendur u vendos si në dispozitë të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

ZL.Anr. 339/2017 më datën 22.10.2017.

Kryesuesi i Panelit
Adnan Konushevci



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118 par. 4 të LZP-së.